

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: **PAKR 547/14**

Më: **12 qershor 2015**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Radostin Petrov, kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues si dhe gjyqtarët kosovarë të Gjykatës së Apelit Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti si anëtarë të kolegjit, në pjesëmarrjen e zyrtarëve ligjorë të EULEX-it Alan Vasak dhe Anne-Gaëlle Denier, në cilësinë e procesmbajtësve,

Në lëndën penale kundër të pandehurve:

A.C., emri i babait [], emri i nënës [], i lindur më [] në fshatin [];

R.O., emri i babait [], emri i nënës [], i lindur më [] në [];

Të akuzuar sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit nr. PP. 465-6/09 të ngritur më 13 gusht 2009, të konfirmuar më 5 tetor 2009 si në vijim: **A.C.** për veprat penale të **Vrasjes së rëndë**, sipas nenit 147 (9) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tash e tutje në tekst “KPPK”, në fuqi nga data 6 prill 2004 deri më 31 dhjetor 2012), **Posedim i paautorizuar i armëve**, sipas nenit 374 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tutje në tekst “KPRK”), dhe **Ndihmë në vrasje të rëndë**, sipas nenit 147 (9) të KPPK-së lidhur me nenin 25 të KPPK-së; dhe të gjykuar në shkallë të parë nga Gjykata Themelore me aktgjykimin PKR nr. 383/2009, të datës 9 shtator 2014 si në vijim:

- **A.C.** ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar për veprat penale vrasje e rëndë sipas nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tutje në tekst “KPRK”), në lidhje me nenin 147 (9) të KPPK-së dhe për posedim të paautorizuar të armës, sipas nenit 374 (1) të KPRK-së, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës Themelore ishte konstatuar se ditën e premte më 22 maj 2009, rreth orës 13:40 në fshatin Zabel i Ulët, komuna e Drenasit, **A.C.** duke qenë në posedim të paautorizuar të armës automatike AK-47, me dashje e ka qëlluar me katër plumba të armës AK-47 R.A. i cili ishte duke qëndruar para oborrit të xhamisë, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse të cilat çuan në vdekjen e tij të menjëhershme. Ai

ishite dënuar me dënim unik prej njëzet e pesë (25) vjet burgim dhe ishte urdhëruar ta kompensonte shumën prej 100 eurosh si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale;

- **R.O.** ishte shpallur i pafajshëm dhe ishte **liruar** nga të gjitha akuzat, në përputhje me nenin 364 (1.3) të Kodit të Procedurës Penale – Ligjit nr. 04/L-123 (më tej në tekst “KPP”). Gjykata Themelore ka gjetur se nuk ishte provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **R.O.** ishte i pranishëm dhe i kishte ndihmuar **A.C.** në ditën kur ndodhi vrasja;

Duke vendosur rreth ankesave në vazhdim, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR nr. 383/2009 të datës 9 shtator 2014

- **Ankesës së prokurorit të shtetit, të paraqitur më 24 tetor 2014**
- **Ankesës së mbrojtësit Destan Rukiqi në emër të të pandehurit A.C., të paraqitur më 27 tetor 2014**

Pas shqyrtimit të propozimit të prokurorit të apelit të parashtruar më 25 nëntor 2014;

Pas mbajtjes së seancës publike të kolegjit të apelit më 10 qershor 2015;

Pas këshillimit dhe votimit të datës 12 qershor 2015;

Në bazë të neneve 389, 390, 394, 398 dhe 401 të KPP-së;

Merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **Refuzohet si e pabazë ankesa e mbrojtësit Destan Rukiqi për të pandehurin A.C..**
- II. **Refuzohet si e pabazë ankesa e prokurorit të shtetit.**
- III. **Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR nr. 383/2009, i datës 9 shtator 2014.**

ARSYETIM

I. PROCEDURA PËRKATËSE E GJERTANISHME

Ngjarjet të cilat i paraprinë kësaj lënde penale kanë ndodhur ditën e premte më 22 maj 2009 rreth orës 13:40 në fshatin Zabel i Ulët, komuna Drenas. **A.C.** ishte në posedim të paautorizuar të armës automatike AK-47, kur me dashje e ka qëlluar katër herë me AK-47 vjehrrin e tij - R.A., i cili ishte duke qëndruar para oborrit të xhamisë, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse të cilat quan në vdekjen e tij të menjëhershme.

Më 22 maj 2009, të pandehurit **A.C.** dhe **R.O.** janë arrestuar dhe janë vendosur në paraburgim. Paraburgimi kundër të dy të pandehurve është vazhduar disa herë nga ajo kohë. **A.C.** ka qenë në paraburgim nga data 22 maj 2009 deri në shpalljen e aktgjykimit. Më 14 qershor 2014, Gjykata Themelore e ka urdhëruar ndërprerjen e paraburgimit ndaj **R.O.**.

Më 24 maj 2009, Policia e Kosovës ka bërë kallëzimin penal nr. 2009-AG-0424 në prokurorinë publike të qarkut të Prishtinës.

Më 13 gusht 2009, prokuroria publike e qarkut të Prishtinës e ka ngritur aktakuzën PP. Nr. 465-6/09, duke e akuzuar **A.C.** për vrasje të rëndë, sipas nenit 147 (9) të KPPK-së dhe për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, sipas nenit 328 (2) të KPPK-së, ndërsa **R.O.** për ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, sipas nenit 147 (9) të KPPK-së, lidhur me nenin 25 të KPPK-së. Më 5 shtator 2009, Gjykata Themelore e ka konfirmuar në tërësi aktakuzën. Lënda është proceduar në shqyrtim gjyqësor me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët vendorë. Më 8 tetor 2013, megjithatë, me kërkesë të të pandehurve, kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, në bazë të Ligjit mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligjit Nr. 03-L-053), ka vendosur që lëndën në fjalë t'ua caktojë gjyqtarëve të EULEX-it me qëllim të parandalimit të shtyrjes së mëtejshme të procedurës.

Shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë është mbajtur në seancat e datës 15, 18 nëntor; 11 dhjetor 2013; më 17, 21, 23 janar; më 13 shkurt; më 7 mars; më 11 prill; më 2 korrik dhe më 5 shtator 2014, ndërsa këshillimet dhe votimi është mbajtur më 5 shtator 2014, ndërsa aktgjykimi është shpallur më 9 shtator 2014. Më datën 9 shtator 2014, trupi gjykues po ashtu e ka vazhduar paraburgimin ndaj **A.C.** deri kur aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Aktgjykimi me shkrim i është dërguar **R.O.** dhe mbrojtësit të tij më 16 tetor 2014; **A.C.** më 20 tetor 2014 kurse mbrojtësit të tij më 13 tetor 2014, ndërsa prokurorit të shtetit më 10 tetor 2014. Më 24 tetor 2014, prokurori i shtetit ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit. Më 27 tetor 2014, **A.C.**, përmes mbrojtësit të tij, po ashtu e ka apeluar aktgjykimin në fjalë.

Më 12 nëntor 2014, mbrojtësi i **R.O.**t ka parashtruar përgjigje në ankesën e prokurorit të shtetit.

Lënda pastaj ka kaluar në Gjykatën e Apelit për vendosje të ankesave më 7 nëntor 2014.

Më 25 nëntor 2014, prokurori i apelit i shtetit ka parashtruar propozimin e tij.

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit është mbajtur më datën 10 qershor 2015, në praninë e **A.C.**, mbrojtësit të tij dhe mbrojtësit të palës së dëmtuar Ramë Gashi. **R.O.** dhe mbrojtësi si dhe prokurori i shtetit kanë munguar.

Kolegji i apelit është këshilluar dhe ka votuar më datën 12 qershor 2015.

I. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa e A.C.t

Avokati mbrojtës Destan Rukiqi më 27 tetor 2014 ka parashtruar ankesën e datës 24 tetor 2014 pranë Gjykatës Themelore në emër të të pandehurit **A.C.** për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale,
- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike,
- Shkeljes së ligjit penal,
- Vendim të gabuar mbi sanksionet penale

Sa u përket **shkeljeve të dispozitave të procedurës penale**, mbrojtësi paraqet se aktgjykimi ka tejkaluar aktakuzën, në kundërshtim me nenin 384 (1.10) të KPP-së, duke pasur parasysh se lënda e prokurorisë në aktakuzë ishte se **A.C.** ka kryer vepër penale në shenjë të “hakmarrjes së paskrupull” por asnjëherë për ndonjë “motiv tjetër të ultë”. Sipas pikëpamjes së tij, hakmarrja e paskrupull përbën motiv në vete. Për më tepër ai pohon se aktgjykimi ka cenuar nenin 384 (1.12) të KPP-së sepse nuk ishte përpiluar në përputhshmëri me nenin 370 (2) deri në (8) të KPP-së. Në veçanti, ai pohon se: (i) aktgjykimit i mungon data e përpilimit dhe se i njëjti e përmban vetëm datën e shpalljes; (ii) dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe në kundërshtim me dispozitivin e aktakuzës; (iii) dispozitivi i aktgjykimit tregon se **A.C.** ka kryer veprat penale “në bashkëkryerje” gjë e cila nuk mund të qëndrojë duke e pasur parasysh se i pandehuri i dytë **R.O.** u lirua nga akuzat; dhe (iv) përshkrimi faktik i veprimeve të **A.C.**, sikurse përshkruhet në dispozitivin e aktgjykimit, korrespondon me cilësimin juridik të vrasjes sipas nenit 146 të KPPK-së dhe jo me atë të vrasjes së rëndë, sipas nenit 147 (9) të KPPK-së.

Sa i përket **vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të fakteve**, mbrojtësi paraqet se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar të gjitha provat e administruara në gjykim në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Sipas tij, ndonëse nuk është kontestuese se **A.C.** e ka privuar nga jeta **R.A.**, provat nuk e konfirmojnë se ai e ka bërë këtë për shkak të hakmarrjes së paskrupullt. Avokati mbrojtës më tej

pohon se provat, e posaçërisht dëshmitë e O.M., motrave të të pandehurit, **R.O.** dhe psikologut ekspert tregojnë se R.A. ka ndërhyrë në jetën martesore të të pandehurit dhe ka pasur sjellje armiqësore. Ai po ashtu vë në pah se ish gruaja e të pandehurit, Q.A., nuk ishte kujdesur për fëmijët e saj.

Sa i përket **shkeljeve të ligjit penal**, mbrojtësi paraqet se Gjykata Themelore ka gabuar në konstatimin se janë përmbushur elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë për shkak të hakmarrjes së paskrupull, sipas nenit 147 (9) të KPPK-së. Ai shton më pas se vrasja e R.A. ishte kryer si “hakmarrje” por nuk ishte hakmarrje e “paskrupullt” për të përbërë vrasje të rëndë në kuptim të nenit 147 (9) të KPPK-së. Mbrojtësi pohon se vepra penale duhet të ri-cilësohet si vrasje, nën nenin 146 të KPPK-së.

Së fundi, sa i përket **vendimit mbi sanksionet penale**, mbrojtësi pohon se Gjykata Themelore ka gabuar në shqiptimin e dënimit unik prej 25 vjet duke pasur parasysh se sipas nenit 38 (1) të KPPK-së, dënimi me burgim nuk mund t'i tejkalojë 20 vjet. Përveç kësaj, ai pohon se Gjykata Themelore i ka vlerësuar siç duhet rrethanat lehtësuese sa i përket të pandehurit. Ai po ashtu thekson se koha e kaluar në paraburgim është dashur të ndikojë në dënim pasi që kjo përbën shkelje të të drejtës së të pandehurit për tu gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Mbrojtësi pohon se Gjykata Themelore ka gabuar kur është mbështetur në hakmarrjen e paskrupull si rrethanë rënduese duke pasur në konsideratë se kjo përbën element të veprës penale. Më pas ai pohon se vepra penale e mbajtjes në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armës, sipas nenit 374 (1) të KPRK-së bie në Ligjin për amnisti nr. 04/L-209 dhe aktgjykimi duhet të sillet si refuzues në këtë aspekt, në përputhje me nenin 363 (1.3) të KPP-së.

Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, mbrojtësi kërkon nga Gjykata e Apelit që ta prishë aktgjykimin dhe lëndën ta kthejë në Gjykatën Themelore për rigjykim.

B. Ankesa e prokurorit të shtetit

Prokurorja e shtetit Fikrije FEJZULLAHU më 24 tetor 2014 ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës Themelore për shkak të:

- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike
- Shkeljes së ligjit penal
- Vendimit të gabuar mbi sanksionet penale

Në mënyrë specifike, prokurorja e shtetit pohon se Gjykata Themelore nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike sa i përket të pandehurit **R.O.** duke pasur parasysh se provat konfirmojë përtej çdo dyshimi të bazuar se ai i ka ndihmuar **A.C.** në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, sidomos dëshmia e dëshmitarit F.F. ose fakti se disa mbetje baruti u gjetën në duart e të pandehurit. Prokurorja e shtetit më tej paraqet se Gjykata Themelore ka gabuar kur

nuk e ka konsideruar rrethanë rënduese për **A.C.** se ai ka kryer veprë penale nga hakmarrja e paskrupull.

Për të gjitha këto arsye, prokurorja e shtetit propozon që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin, lëndën ta kthej në rigjykim ose ndaj të pandehurve të shqiptojë dënim më të lartë me burgim.

C. Përgjigjja nga R.O.

Mbrojtësi Ibrahim Z. Dobruna në emër të të pandehurit **R.O.** ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës më 12 nëntor 2014. Ai kundërshton ankesën e prokurores së shtetit për arsye se nuk kishte prova të paraqitura në gjykim përtej dyshimit të bazuar për ta provuar se **R.O.** ishte në vendin e ngjarjes në momentin kritik dhe ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në mënyrë të veçantë, ai pohon se dëshmitari F.F. asnjëherë nuk ka qenë i sigurt në dëshminë e tij se atje ka qenë edhe një person i dytë në veturë dhe sido që të jetë ai nuk e ka identifikuar këtë person të ketë qenë **R.O.** Ai thekson se dëshmitarët e tjerë, si S.G., O.M., A.J. dhe A.H., përkundrazi kanë konfirmuar se ata e kanë parë vetëm një person në vendin e ngjarjes. Mbrojtësi parqet se Gjykata Themelore i ka vlerësuar provat siç duhet me lirim të **R.O.** Për këtë arsye ai i propozon Gjykatës së Apelit që ta konfirmojë aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Themelore.

D. Propozimi i kryeprokurorit të shtetit

Prokurori i apelit Idain Smailji më 25 nëntor 2014 ka parashtruar një propozim duke kërkuar nga Gjykata e Apelit që ta miratojë ankesën e prokurores së shtetit dhe ta refuzojë si të pabazë ankesën e **A.C.** Në mënyrë më specifike, ai paraqet se bazuar në prova, veprimet e **R.O.** përbëjnë të gjitha elementet substanciale të veprës penale të ndihmës në vrasje të rëndë, e në veçanti deklarata e dëshmitarit F.F. Përveç kësaj, ai pohon se Gjykata Themelore e ka shkelur nenin 73 të KPRK-së kur nuk ka arritur të marrë parasysh peshën e veprës kur ka përcaktuar dënimin ndaj **A.C.**, dhe është dashur të shqiptojë një periudhë më të gjatë burgimi. Prokurori i apelit më tej pohon se në kundërshtim me atë që e pohon **A.C.**, Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike që përbën veprat penale të vrasjes së rëndë dhe mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve. Në këtë aspekt, ai paraqet se kjo e fundit nuk mund të mbulohet me amnisti pasi që **A.C.** ka privuar nga jeta një person kur e ka përdorur armën në fjalë.

II. TË GJETURAT E KOLEGJIT TË APELIT

A. Kompetenca e kolegjit

Në bazë të nenit 472 (1) të KPP-së, kolegji shqyrton nëse është kompetent për çështjen dhe pasi që nuk ka kundërshtime nga palët, kolegji mjaftohet me kaq. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për t'i vendosur ankesat sipas neneve 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji Nr. 03/L-199).

Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar sipas nenit 19 (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

B. Pranueshmëria e ankesave

Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 9 shtator 2014. Aktgjykimi me shkrim i është dërguar **A.C.t** më 20 tetor 2014, mbrojtësit të tij më 13 tetor 2014, ndërsa prokurorit të shtetit më 10 tetor 2014. Të gjitha ankesat janë parashtruar brenda afatit ligjor prej 15 ditësh të përcaktuar me nenin 380 (1) të KPP-së. Të dyja ankesat janë parashtruar nga personat e autorizuar dhe i përmbajnë të gjitha informatat e përcaktuara me nenin 376 *et seq* të KPP-së, prandaj për këtë arsye janë të pranueshme.

C. Të gjeturat mbi çështjet meritore

Kolegji i apelit do t'i diskutojë të gjitha shkaqet e ankesës së ngritur nën pikat përkatëse të radhitura në vijim. Kolegji së pari do ta shqyrtojë ankesën e prokurorit të shtetit pasi që ajo trajton një çështje të veçantë të lirit të pandehurit **R.O.** Së dyti, kolegji do t'i diskutojë kundërshtimet e ngritura në ankesën e të pandehurit **A.C.**, dhe atë: (i) shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike; (iii) shkeljes së ligjit penal; dhe (iv) vendimit të gabuar mbi sanksionet penale.

1. Ankesa e prokurorit të shtetit

Kolegji i apelit ka shqyrtuar me kujdes deklaratat e dhëna nga dëshmitari F.F. në polici më 22 maj 2009 dhe në prokurori më 12 qershor 2009, si dhe dëshminë e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor më 17 janar 2014, dhe vëren se deklarata e tij rreth ngjarjeve të datës 22 maj 2009 është e ngjashme në të gjitha aspektet, përkatësisht, se ai mendon por nuk mund të jetë i sigurt se i kishte parë dy veta në veturë. Sidoqoftë, kolegji më tutje vëren se në asnjë rast F.F. nuk e ka identifikuar këtë personin e dytë si **R.O.** Për këtë arsye, kolegji i apelit pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se kjo provë nuk e vërteton përtej dyshimit të arsyeshëm se edhe **R.O.** ka qenë në veturë dhe e ka ndihmuar **A.C.** në kryerjen e veprës penale në fjalë.

Sa i përket faktit se është gjetur ca mbetje baruti në duart e **R.O.**, Gjykata e Apelit pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se provat e prezantuara, në veçanti raportet e ndryshme të ekspertizës, nuk lejojnë që të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se **R.O.** ka qenë i pranishëm së bashku me **A.C.** dhe i ka ndihmuar atij në kryerjen e veprës penale. Prova në fjalë në të vërtetë tregon se shtrëngimi i duarve në mes të **R.O.** dhe **A.C.** mund ta shpjegojë praninë e

mbetjes së grimcave të barutit në dorën e djathtë të **R.O.**, sepse këto grimca mund të kalohen edhe me shtrëngim duarsh.

Si përfundim, kolegji i apelit e refuzon ankesën e prokurorit të shtetit si të pabazë dhe e vërteton lirim të **R.O.** siç është vendosur edhe nga Gjykata Themelore.

2. Ankesa e **A.C.t**

(i) Pretendimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

Së pari, për dallim nga ajo që pohon **A.C.**, kolegji nuk gjen se aktgjykimi në fjalë e ka tejkaluar aktakuzën. Në aktakuzë, në mënyrë të qartë tregohet se **A.C.** akuzohet për vrasje të rëndë sipas nenit 147 (9) të KPPK-së. Megjithatë, nuk specifikohet nëse hakmarrja është e paskrupullt apo për motive të ulëta. Sipas pikëpamjes së kolegjit, dispozitivi i aktgjykimit nuk i ik asaj çfarë theksohet në aktakuzë dhe nuk i zgjeron akuzat të cilat i përmban aktakuza, pasi që si “hakmarrja e paskrupullt” ashtu edhe ajo “për motive të tjera të ulëta” janë të përfshira në kuadër të nenit 147 (9) të KPPK-së.

Duke iu kthyer tani shkeljes së pohuar me nenin 384 (1.12) të KPP-së se aktgjykimi i kundërshtuar nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPP-së, kolegji i apelit e refuzon si të pabazë këtë arsye të dhënë në ankesë.

Kolegji së pari konstaton se, përderisa është e vërtetë se në aktgjykim mungon data e përpilimit me shkrim të tij, kopja me shkrim i aktgjykimit në fjalë palëve iu është dërguar më 13 tetor 2014. Prandaj, mund të vlerësohet se aktgjykimi në fjalë është përpiluar pak para kësaj date. Duke rikujtuar se në bazë të nenit 369 (1) të KPP-së, aktgjykimi i arsyetuar në rastet me paraburgim duhet të përpilohet brenda 15 ditësh nga shpallja e aktgjykimit, porse në rastet kur lënda është komplekse, ky afat ligjor mund të vazhdohet deri më 60 ditë shtesë, kolegji vëren se më 23 shtator 2014, kryetarit të kolegji i është dhënë leja për ta vazhduar afatin e përpilimit të aktgjykimit në përputhje me këtë dispozitë. Kolegji i apelit prandaj është i bindur se ky aktgjykim është përpiluar brenda afatit të vazhduar ligjor dhe se fakti që në aktgjykim mungon data përbën gabim të vogël të parëndësishëm, i cili nuk ka ndikim në të drejtat e mbrojtjes në procedurë. Kolegji prandaj konstaton se duhet të zbatohet rregulla *de minimis*. Sidoqoftë, vlen të përmendet se mbrojtja nuk tregon asnjë paragjykim ndaj të pandehurit për shkak të mungesës së datës në aktgjykim.

Gjykata e Apelit e hedh poshtë si të pambështetur dhe të pazhvilluar argumentin e mbrojtjes se përshkrimi faktik i dispozitivit është “krejtësisht ndryshe” nga përshkrimi i bërë në aktakuzë.

Sa i përket pohimit se dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor dhe i paqartë, kolegji konsideron se përkundrazi – dispozitivi në fjalë është i qartë, logjik dhe nuk bie në kundërshtim

me veten apo me arsyetimin, sepse ofron një përshkrim të kuptueshëm të fakteve vendimtare dhe i përmban të gjitha të dhënat e domosdoshme të përshkruara me nenin 370 (3) dhe (4) të KPP-së, lidhur me nenin 365 të KPP-së.

Më tutje, në kundërshtim me parashtrësën e **A.C.**, dispozitivi i aktgjykimit nuk e thekson se i pandehuri i ka kryer veprat penale në “bashkëkryerje”. Referimi që i është bërë shprehjes “in concurrence (të bashkuara)” në versionin në gjuhën angleze të aktgjykimit i referohet faktit se kolegji ka konstatuar se **A.C.** i ka kryer dy vepra penale për të cilat është gjykuar në të njëjtën kohë dhe nga e njëjta instancë.

Edhe pse është e vërtetë se dispozitivi nuk i përmend në mënyrë specifike motivet e paskrupullta prapa veprimit të **A.C.**, kolegji i apelit është i pikëpamjes se kjo gjë përbën vetëm një mospërputhje të vogël dhe se duhet të aplikohet rregulla *de minimis*. Kolegji gjen se dispozitivi mbetet plotësisht koherent me arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe se, lexuar në kombinim, ai i pasqyron qartë të gjeturat e shtjelluara në të dhe se aktgjykimi në tërësi e qartëson vendimin e trupit gjykues. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit e refuzon pretendimin e mbrojtjes se përshkrimi faktik i akteve të **A.C.**, i dhënë në dispozitiv i përshtatet cilësimit juridik të vrasjes në bazë të nenit 146 të KPPK-së.

Kolegji i apelit

Kolegji i apelit e rikujton se është një tjetër çështje nëse konkluzionet e Gjykatës Themelore mbi vërtetimin e fakteve janë të sakta si çështje e ndarë dhe se kjo do të vlerësohet në pjesën në vijim të aktgjykimit.

(ii) Pretendimet për vërtetimin e gabueshëm dhe / ose jo të plotë të gjendjes faktike

Para vlerësimit të çështjeve meritore të argumenteve të prezantuara nga avokati mbrojtës, kolegji i apelit e rithekson standardin e shqyrtimit lidhur me të gjeturat faktike të bëra nga trupi gjykues. Është e qartë nga përkufizimet e “vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike” dhe “vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike”, të dhëna në nenin 386 të KPP-së se nuk mjafton që i pandehuri vetëm të demonstrojë një lajthitje juridike apo vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga trupi gjykues. Në vend të kësaj, duke e pasur parasysh se kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabueshëm apo jo i plotë i gjendjes faktike ka të bëjë me ‘faktin material’, i pandehuri duhet po ashtu ta vërtetojë se vërtetimi i gabueshëm apo jo i plotë i gjendjes faktike vërtet lidhet me faktin material, përkatësisht, se fakti në fjalë është shumë i rëndësishëm për aktgjykimin e marrë. Për më tepër, është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit duhet ta respektojë të gjeturat faktike të trupit gjykues sepse ata janë në pozitë më të mirë për vlerësimin e provave. Gjykata e Apelit ka obligim që të sigurojë se faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm të vërtetohen me vërtetësi dhe në mënyrë të plotë.

Duke i pasur këto parasysh, dhe pas shqyrtimit të hollësishëm të provave dhe analizave të këtyre provave nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit nuk bindet nga parashtrësia e të pandehurit **A.C.** Nga ana tjetër, është plotësisht e bindur me konkluzionet dhe arsyetimin e Gjykatës Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar. Kolegji i apelit më tutje është i bindur se trupi gjykues e ka bërë një analizë të kujdesshme dhe të përpiktë të provave të administruara në gjykim, në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Për dallim nga pretendimi i mbrojtjes, kolegji nuk konstaton se Gjykata Themelore i ka vlerësuar në mënyrë selektive dëshmitë e dëshmitarëve.

Në mënyrë më specifike, përkitazi me dëshmitarin O.M., kolegji, pas shqyrtimit të dëshmisë së tij më 7 mars 2014, e gjen se ngaqë dëshmitari në fjalë insistonte se kishte harruar shumëçka dhe se nuk kishte dëshirë ta studionte thellë natyrën e konfliktit në mes të R.A. dhe **A.C.**, pasi që ai kishte mbetur ndërmjetës për pajtimin e këtyre dy familjeve, dëshmia e tij kishte një vlerë të ulët provuese për të treguar mungesën e pohuar të hakmarrjes së paskrupullt në emër të **A.C.** Gjykata e Apelit pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se dëshmia e O.M. megjithatë e konfirmon se viktima R.A. nuk ka qenë njeri i rrezikshëm dhe se nuk e ka penguar të bijën Q.A. që ta vazhdonte martesën e saj me **A.C.**.

Përderisa kolegji e vëren se aktgjykimi i kundërshtuar nuk i referohet shprehimisht incidentit me R.A. të raportuar nga motrat e **A.C.** – A. dhe M.C. gjatë dëshmimeve të tyre në gjykimin e datës 17 janar 2014, kolegji megjithatë është i bindur se Gjykata Themelore i ka vlerësuar dëshmitë e tyre në tërësi dhe nuk konsideron që ky element ka mundur të përbëjë një fakt të rëndësishëm faktik për epilogun e këtij gjykimi. Sipas pikëpamjes së Gjykatës së Apelit, deklaratat e tyre nuk i dëmtojnë të gjeturat faktike të Gjykatës Themelore se **A.C.** e ka vrarë të vjehrrin nga hakmarrja e paskrupullt. Përveç kësaj, vlen të thuhet se ekzistimi i raporteve të vështirësuar në mes të familjeve të **A.C.** dhe R.A. është fakt i pakontestueshëm në aktgjykimin e kundërshtuar. Po ashtu, Gjykata e Apelit konstaton se sjellja armiqësore nga ana e viktimës R.A. apo se ai ka mundur të jetë pengesë për bashkimin sërishmi të çiftit në fjalë, siç pretendohet nga **A.C.**, nuk mbështetet nga provat e administruara në gjykim. Në këtë aspekt, kolegji e përkujton se nuk është e kontestueshme se **A.C.** ka abuzuar fizikisht dhe nga aspekti psikologjik me Q.A. dhe se i njëjti është dënuar për dhunë familjare.

Sidoqoftë, kolegji pajtohet me qëndrimin e Gjykatës Themelore se edhe nëse provat e sjella në gjykim do të sugjerorin se viktima i kishte bërë presion të bijës në mënyrë që ajo ta braktiste **A.C.**, prapëseprapë do të vërtetohej vepra penale e vrasjes së rëndë nga hakmarrja e paskrupullt.

Sa i përket dëshmisë së ekspertes së psikologjisë N.M., të dhënë më 17 janar 2014, edhe pse kjo eksperte kishte pranuar se situata familjare ka mundur t'i shkaktoje mërzitje **A.C.**, ajo prapë ishte kategorike lidhur me faktin se kjo rrethanë “nuk do ta ulte qëndrimin e tij kritik ndaj gjërave”. Ajo po ashtu e kishte theksuar gjatë dëshmisë së saj se **A.C.** nuk vuante nga asnjë çrregullim mendor apo sëmundje psikiatrike siç është çrregullime me personalitetin.

Kolegji nuk është i bindur se fakti që i pandehuri në fjalë ka vuajtur nga përgjegjësia emocionale dhe egocentrizmi, siç konstatohet nga ekspertja, dhe se kjo gjë e ka parandaluar atë nga vrasja e të vjehrrit për hakmarrje të paskrupullt apo se kjo të ketë pasur ndonjë ndikim në aftësinë e tij për të kryer veprën penale në fjalë. Për këtë arsye, kolegji i apelit në mënyrë të fuqishme e refuzon pretendimin e mbrojtjes se i pandehuri në fjalë kishte qenë “në prag të çmendurisë”.

Për më tepër, sa i përket faktit se Q.A. nuk ishte përkujdesur për fëmijët e saj, kolegji vëren se Gjykata Themelore e ka marrë parasysh situatën familjare të të pandehurit dhe faktin se ai e kishte fituar të drejtën e kujdestarisë mbi fëmijët e tij. Mbrojtësi nuk e thekson asnjë gabim në emër të trupit gjykues në këtë drejtim, dhe nuk e mbështet me prova se si ky element do të mund të ishte i rëndësishëm jetike për epilogun e gjykimit.

Si përfundim, kolegji i apelit është i bindur se Gjykata Themelore e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe se argumentet e ngritura në ankesë në emër të **A.C.** nuk i dëmtojnë të gjeturat në fjalë.

(iii) Pretendimet për shkelje të ligjit penal

Tash duke iu kthyer asaj nëse Gjykata Themelore ka gabuar pse nuk e ka ri-cilësuar veprën penale si ‘vrasje’ në bazë të nenit 146 të KPPK-së, Gjykata e Apelit është e bindur se provat e administruara në gjykim vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **A.C.** e ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë nga hakmarrja e paskrupullt, sipas nenit 147 (9) të KPPK-së.

Përderisa mbrojtësi ka të drejtë kur pohon se jo çdo lloj i hakmarrjes mund të cilësohet si “e paskrupullt” në bazë të nenit 147 (9) të KPPK-së, Gjykata e Apelit megjithatë konstaton se në rrethanat e lëndës në fjalë, hakmarrja e paskrupullt karakterizohet me prova për dallim nga hakmarrja e thjeshtë.

Kolegji konstaton ashtu siç e pranon edhe vetë mbrojtësi në ankesën e tij se **A.C.** e ka privuar nga jeta viktimën R.A. ‘në shenjë të hakmarrjes’ për shkak të raporteve të tyre armiqësore dhe për shkak se ai e mbante të vjehrrin përgjegjës për shkatërrimin e marrëdhënies së tij me gruan. Gjykata e Apelit pajtohet me mendimin e trupit gjykues se privimi i viktimës nga jeta për arsyet në fjalë përbën reagim ekstrem, tejet disproporcional dhe reaksion të pakthyeshëm, duke e karakterizuar si krim të paskrupullt. Kjo gjë më tej konfirmohet me SMS-në nënçmuese pa ndjenja të cilën **A.C.** ia kishte dërguar Q.A. menjëherë pas kryerjes së krimit. Përveç kësaj, veprimet e tij kanë qenë të paramenduara, fakt ky që nuk kontestohet nga i pandehuri.

Për këtë arsye, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata Themelore nuk ka gabuar kur e ka shpallur fajtor **A.C.** për vrasje të rëndë në bazë të nenit 147 (9) të KPPK-së dhe nuk e ka ri-cilësuar veprën penale në fjalë vetëm si vrasje sipas nenit 146 të KPPK-së.

(iv) Pretendimet lidhur me vendimin mbi sanksionin penal

Kolegji së pari e refuzon parashtrësën që Gjykata Themelore ka gabuar kur e ka shqiptuar dënimin unik prej 25 vjetësh burgim. Duke e pasur parasysh se neni 147 i KPPK-së përcakton që për vrasje të rëndë shqiptohet dënim me burgim afatgjatë dhe duke e pasur parasysh se në bazë të nenit 37 (2) të KPPK-së, dënimi me burgim afatgjatë duhet të jetë në mes të 21 dhe 40 vjetësh, atëherë dënimi i shqiptuar prej 25 vjetësh burgim i përshtatet kufirit të përcaktuar.

Për më tepër dhe për dallim nga pohimi i mbrojtjes, Gjykata e Apelit është e bindur se Gjykata Themelore i ka respektuar dispozitat e nenit 370 (5) të KPP-së dhe nenin 71 (2) (1) të KPPK-së pasi që në dispozitiv e ka treguar dënimin e përgjithshëm unik prej 25 vjetësh burgim si dhe dënimin për secilën veprë penale veç e veç, përkatësisht dy vjet për mbajtje në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve si dhe 25 vjet për vrasje të rëndë.

Kolegji me kujdes ka rishikuar rrethanat lehtësuese të vërtetuara nga Gjykata Themelore dhe sfidat e ngritura nga mbrojtja në këtë drejtim. Kolegji konstaton se, për dallim nga parashtrësat e mbrojtjes, ka marrë në konsideratë faktin se i pandehuri është baba i fëmijëve të mitur. Gjykata Themelore po ashtu ka marrë parasysh faktin se **A.C.** ka bashkëpunuar gjatë procedurës paraqet një rrethanë lehtësuese. Për këtë arsye, kolegji i apelit nuk e konsideron se Gjykata Themelore ka gabuar në vlerësimin e rrethanave personale të të pandehurit si rrethana lehtësuese.

Përveç kësaj, kolegji e refuzon pohimin e mbrojtjes se koha e kaluar nga **A.C.** në paraburgim është dashur të ketë ndikim në caktimin e dënimit. Përderisa Gjykata e Apelit është e vetëdijshme për kohën e kaluar në paraburgim nga ana e të pandehurit, megjithatë nuk e konsideron këtë faktor si rrethanë lehtësuese. Më tutje, ajo e refuzon si të pambështetur dhe të paqëndrueshëm argumentin se koha e kaluar në paraburgim përbën shkelje të së drejtës së **A.C.** për t'u gjykuar pa vonesa të panevojshme.

Kolegji i apelit e vëren se Gjykata Themelore duket se e ka marrë në konsideratë faktin se vrasja e kryer në shenjë të “hakmarrjes së paskrupullt” është konsideruar si rrethanë rënduese kur e ka caktuar dënimin në lëndën në fjalë. Këto rrethana tashmë janë elemente të veprës penale për të cilën **A.C.** është shpallur fajtor, përkatësisht për veprën vrasje e rëndë nga hakmarrja e paskrupullt. Prandaj, këto rrethana janë shterur kur bëhet fjalë për caktimin e dënimit sepse elementet e krimit tashmë janë pasqyruar në kuadër të dënimit për veprën penale. Është rregull e përgjithshme dhe pasojë juridike e parimit *ne bis in idem* ose rrezikut të dyfishtë se rrethanat të cilat përbëjnë elementet e veprës penale për të cilat i pandehuri shpallet fajtor nuk mund të merren parasysh për caktimin e dënimit në fazën e shpalljes së dënimit.¹ Kolegji prandaj

¹ *Shih p.sh.* Aktgjykimin PAKR 1122/2012, 25 prill 2013, paragrafi 58.

konstaton se Gjykata Themelore në mënyrë të palejueshme e ka llogaritur dyfish një element të veprës penale si faktor rëndues.

Megjithatë, pas shqyrtimit të kujdesshëm të rrethanave të lëndës në fjalë dhe të rrethanave rënduese, dhe duke i pasur parasysh rregullat e përgjithshme mbi dënimin të përcaktuara me nenin 64 të KPPK-së, Gjykata e Apelit vëren se dënimi me burgim i shqiptuar ndaj **A.C.** në kohëzgjatje prej 25 vjetësh, është dënim i drejtë duke i pasur parasysh rrethanat e rastit dhe dënimin e përcaktuar me nenin 147 të KPPK-së, d.m.th. shtrirjen e dënitimit prej 21 deri në 40 vjet burgim afatgjatë. Kolegji prandaj është i bindur se gabimi i Gjykatës Themelore nuk ka ndikim dhe se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është caktuar drejt prej Gjykatës Themelore.

Në këtë drejtim, dhe duke e pasur parasysh këtë gjetjen e gabuar, kolegji e refuzon pohimin e prokurorit të shtetit se Gjykata Themelore ka gabuar kur nuk i ka marrë parasysh rrethanën rënduese për **A.C.** se e ka kryer veprën penale nga hakmarrja e paskrupullt.

Në kundërshtim me pohimin e mbrojtjes, Gjykata e Apelit konstaton se rrethanat e rastit në fjalë, vepra penale e mbajtjes në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 (1) të KPRK-së nuk përfshihet në Ligjin mbi amnistinë nr. 04/L-209. Vërtet, siç përcaktohet me nenin 4 (1.3) të Ligjit mbi amnistinë nr. 04/L-209, amnistia nuk vlen për ato vepra penale të cilat kanë rezultuar me lëndime të rënda trupore apo me vdekje. Pasi që **A.C.** është konstatuar se ia ka shkaktuar vdekjen R.A.t duke e përdorur armën automatike AK – 47 pa autorizim, atëherë kolegji i apelit konstaton se Gjykata Themelore nuk ka gabuar kur e ka dënuar për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 (1) të KPRK-së.

Duke i pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të cilat janë vlerësuar drejt nga Gjykata Themelore dhe duke e pasur parasysh faktin se hakmarrja e paskrupullt nuk mund të konsiderohet si faktor rëndues dhe duke e pasur në konsideratë se dënimi maksimal i përcaktuar për veprën penale të vrasjes së rëndë është burgimi afatgjatë prej 40 vjetësh në bazë të nenit 147 të KPPK-së, kolegji konstaton se dënimi prej 25 vjetësh burgim i shqiptuar nga Gjykata Themelore nuk është dënim jo-proporcional dhe si i tillë e pasqyron dënimin unik në bazë të rrethanave të lëndës në fjalë.

III. KONKLUZION

Gjykata e Apelit, për arsyet e shtjelluara më lart, e refuzon ankesën e prokurorit të shtetit dhe ankesën e mbrojtjes, ndërsa e vërteton aktgjykimin e kundërshtuar.

Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar më datën 5 gusht 2015.

Kryetari i kolegjit

Radostin Petrov
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Xhevdet Abazi
Gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit

Anëtari i kolegjit

Abdullah Ahmeti
Gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit

Procesmbajtëse

Anne-Gaëlle Denier
Zyrtare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR 547/14
12.06.2015